



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 140

Tiranë – E mërkurë, 27 shtator 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12, datë 26.9.2023	Për miratimin e metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2023..... 15903
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 303, datë 19.9.2023	Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”..... 15904
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 304, datë 19.9.2023	Për miratimin e rregullores “Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët”..... 15920
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 305, datë 19.9.2023	Për miratimin e rregullores “Mbi dhënien e lejes së papaguar”..... 15922
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 362/14, datë 27.9.2023	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private të cilat preken nga “Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore”..... 15925
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. 381, datë 16.5.2023	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzi Petanaj 15927
	Korrigjim gabimi material në njoftimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 11871, datë 26.7.2022, për hyrjen në fuqi të “Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Mbrojtjen Shoqërore”, nënshkruar më 18.2.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 1.8.2023 15927



UDHËZIM

Nr. 12, datë 26.9.2023

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË,
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT,
PËR SHPËRNDARJEN DHE
PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE
SHTETËRORE, PËR OFRUESIT E
SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, PËR
VITIN BUXHETOR 2023**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; gërmës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të VKM-së nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, si dhe të udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, të ndryshuar; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” dhe të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zbatimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjiellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2023”, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, bashkitë dhe shoqëritë aksionare të ujësjiellës-kanalizimeve.

3. Udhëzimi nr. 20, datë 14.10.2022, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjiellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2022”, shfuqizohet.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

Lidhja 1

METODOLOGJI

**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E
SUBVENCIONEVE SHTETËRORE, PËR
OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN
E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE,
PËR VITIN 2023”**

Kjo metodologji është hartuar në mbështetje të pikës 13, shkronja “dh”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”.

Detajimi i fondit të subvencionit dhe përdorimi i tij për çdo shoqëri rajonale të ujësjiellës-kanalizimeve sh.a. të krijuar dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale, do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahej nga Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (në vijim AKUM-i) në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor subvencione, me llogari ekonomike (603) dhe të gjithë shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, do të përdoret nga AKUM-i, për t'i ofruar ndihmë shoqërive rajonale që janë krijuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, për “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302/2022), dhe shoqërive që janë në procesin e krijimit të shoqërisë rajonale, nëse këto kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë së re rajonale.

3. Prioritet për përdorimin e fondit nga shoqëritë rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale, është likuidimi i detyrimeve emergjente të cilat pengojnë veprimtarinë normale të shoqërisë.



4. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, zëri subvencione (603), do të përdoret nga AKUM-i, si më poshtë:

a) Për shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen ose kanë krijuar shoqërinë rajonale brenda vitit 2023, sipas VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, të subvencionohen me vlerën nga 30 000 000 lekë secila;

b) Pjesa e mbetur e fondit të subvencionit do të përdoret nga AKUM-i për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike të shoqërive rajonale ujësjellës-kanalizime sipas prioriteteve të mëposhtme:

- Shoqëritë që kanë mbi 75 % të prodhimit me ngritje mekanike;

- Shoqëritë që kanë krijuar detyrime të reja për energjinë gjatë vitit 2023, për shkak të kostove të larta të energjisë.

5. Fondi i dhënë sipas pikës 4, germa “a” të kësaj metodologjie të përdoret nga shoqëritë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për sigurimet shoqërore, pagat, energjinë elektrike dhe shpenzime të domosdoshme për nisjen e operimit të shoqërisë rajonale, bazuar në kërkesat e shoqërive rajonale.

6. Fondi i dhënë sipas pikës 4, germa “b” të kësaj metodologjie të përdoret nga shoqëritë për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike.

7. Vlerësimi i nevojave për fondin e dhënë sipas pikës 4/b, si dhe detajimi dhe shpërndarja nga AKUM-i, do të bazohet në të dhënat e raportuara nga shoqëritë rajonale pranë AKUM-it, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara.

8. AKUM-i vlerëson dokumentacionin/të dhënat e paraqitur/a dhe bën shpërndarjen e subvencionit, për shoqëritë rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale.

9. AKUM-i llogarit vlerën e subvencionit që do të përfitojë secila shoqëri rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e shoqërisë rajonale dhe njofton shoqëritë.

10. AKUM-i, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastruktursë së Mbetjeve”, neni 13, shkronja “ë”, ka të drejtë të ushtrojë kontrolle, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondit i subvencionimit.

VENDIM

Nr. 303, datë 19.9.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE PRANË PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 47, 48 dhe 52 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; me propozimin e grupit të punës të ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 184, datë 30.12.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e rregullores ‘Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar’”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 51, datë 19.3.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet edhe në faqen zyrtare *web* të Këshillit.

4. U shpall në Tiranë, sot më 19.9.2023.

KRYETAR
Alfred Balla



RREGULLORE

MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE PRANË PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe i procedurave për ngritjen në detyrë të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*në vijim "Prokuroria e Posaçme"*), bazuar në një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës.

Neni 2

Parimet e ngritjes në detyrë

Ngritja në detyrë në Prokurorinë e Posaçme bazohet në parimet e pavarësisë, procesit të rregullt ligjor, meritokracisë, promovimit, zhvillimit të karrierës, efikasitetit, si dhe konfidencialitetit.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Subjekte të kësaj Rregulloreje janë prokurorët që kandidojnë për ngritje në detyrë në shkallët më të larta, sipas përcaktimeve të neneve 47, 48 dhe 52, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të zbatueshme për vlerësimin dhe renditjen e prokurorëve, që kandidojnë dhe përmbushin kushtet dhe kriteret ligjore për t'u ngritur në detyrë në pozicionet e mëposhtme

- a) prokuror në Prokurorinë e Posaçme;
- b) drejtues në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 4

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë Rregullore, kanë këto kuptime:

a) "*Ditë*" ka kuptimin e ditës kalendarike. Nëse dita e fundit është ditë pushimi, atëherë përfundimi i afatit do të shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

b) "*Këshill*" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

c) "*Prokuror i Posaçëm*" është prokurori në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

d) "*Ngritje në detyrë*" nënkupton kalimin nga:

i. një pozicion në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në një pozicion në Prokurorinë e Posaçme;

ii. një pozicion si prokuror në Prokurorinë e Posaçme, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

e) "*Komision*" është Komisioni i Posaçëm me pesë anëtarë për vlerësimin e kandidatëve për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, që ngrihet pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

f) "*SPAK*" është struktura e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit.

g) "*Kandidat*" është prokurori, i cili shpreh interesin për të plotësuar një pozicion vakant në Prokurorinë e Posaçme ose që kërkon të zgjidhet drejtues i saj.

h) "*Me kualifikim të lartë*" kuptohet vlerësimi maksimal i akorduar për kandidatin, sipas pikëzimit të parashikuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje.

i) "*Me kualifikim të mesëm*" kuptohet vlerësimi mesatar i akorduar për kandidatin, sipas pikëzimit të parashikuar në nenin 23 të kësaj Rregulloreje.

j) "*Me kualifikim të ulët*" kuptohet vlerësimi minimal i akorduar për kandidatin, sipas pikëzimit të parashikuar në nenin 24 të kësaj Rregulloreje.

k) "*Institucionet e rivlerësimit*" janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

l) "*Konfirmuar pas rivlerësimit*" konsiderohet:

i. kandidati i konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimi për të cilin nuk është ankimuar brenda afatit ligjor; ose

ii. pas ankimit, kandidati i konfirmuar në detyrë nga Kolegji i Apelit.

m) "*Ekspert*" është prokurori që ka nivel të lartë të njohurive ose të përvojës, të njohur nga një institucion publik, në lidhje me kriteret e posaçme etike e morale të parashikuara në nenin 18 të kësaj Rregulloreje, për shkak të angazhimit në mësimdhënie në Shkollën e Magistraturës, në



hartimin e legjislacionit, të pjesëmarrjes në komitetet e ekspertëve pranë organizatave vendëse dhe ndërkombëtare në trajnime afatgjata ose botime në fusha që lidhen me objektin e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme të parashikuar nga ligji penal, si dhe aftësitë për të komunikuar drejtpërdrejtë me organizatat apo partnerët ndërkombëtar.

n) “*Përvojë specifike*” nënkupton përvojën e kandidatit si prokuror i transferuar në Prokurorinë e Posaçme, sipas parashikimit të nenit 46, pika 3, dhe vijuese, të ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar.

o) “*Teknikat e posaçme të hetimit*” janë metodat speciale të hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimeve të tjera ligjore, përdorimi i të cilave nuk është i autorizuar për të gjitha llojet e veprave penale, të tilla si: veprimet simuluese, infiltrimi në përbërje të grupit kriminal, dorëzimi i kontrolluar, mbrojtja e dëshmitarit, si dhe teknika të tjera, si: vendimet për kontroll në rastet e hetimeve të veprave penale të korrupsionit, sigurimi me anë të letërporosisë i provave që gjenden jashtë vendit, bashkëpunimi me autoritetet apo dhe me organizatat ndërkombëtare, pjesëmarrja në skuadra apo kryerja e veprimeve të përbashkëta hetimore me to, sigurimi i provave kompjuterike, përdorimi i provave mjekoligjore, si ADN-ja, përdorimi i ekspertizës kontabël, përgjimi elektronik, marrja dhe përdorimi i informacioneve nga vende të huaja, provat kompjuterike, përdorimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose bashkëpunimi në marrëveshjet e fajësisë.

p) “*Çështje të ndërlikuara ligjrisht dhe në fakte*” konsiderohen ato çështje, ku subjekt i hetimit është një funksionar i lartë publik, të cilat kanë një numër të madh të pandehurish (3 ose më shumë të pandebur) ose një numër të madh veprash penale (3 ose më shumë vepra penale), që pasjellin pasoja të rënda për jetën dhe pasurinë e personave ose shkaktojnë dëm të madh ekonomik, të cilat rezultojnë në konfiskimin e aseteve me vlera të mëdha (referuar praktikës ose vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë).

q) “*Hetim proaktiv*” është ai hetim, ku procesi i mbledhjes së provave kryhet njëkohësisht me lindjen e dyshimit për kryerjen e veprës së dyshuar penale, si dhe hetimet që nisen nga prokurori në mungesë të një kallëzimi ose çdo hetim, i cili është dukshëm më i zgjeruar se kallëzimi origjinal.

r) “*Hetim i suksesshëm*” është çdo procedim i dërguar për gjykim në përfundim të të cilit është marrë fajësi ose, kur prokurori tregon se veprimet hetimore kanë qenë shteruese, pavarësisht vendimit të gjykatës.

s) “*Kërkesë e suksesshme për konfiskim*” konsiderohet çdo kërkesë e prokurorit e pranuar nga gjykata, ose kur, ndonëse kërkesa nuk është pranuar nga gjykata, vlerësohet se veprimet e kryera nga prokurori kanë qenë shteruese dhe të sakta.

t) “*Ligji antimafia*” është ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar.

u) “*Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës*” është Komisioni i ngritur pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas kërkesave të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 95/2016, “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, i ndryshuar.

v) “*Vendim verifikimi*” nënkupton vendimin e Këshillit, pas përfundimit të verifikimit të kushteve ligjore për prokurorët e interesuar, pa përfshirë verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit.

w) “*Vendim për renditjen e kandidatëve*” nënkupton vendimin e Këshillit të marrë në përfundim të procedurës së vlerësimit krahasimor të kritereve përzgjedhëse për ngritjen në detyrë e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme, i cili i dërgohet Komisionit të Posaçëm të verifikimit të pasurisë dhe figurës pranë SPAK-ut.

x) “*Vendim për ngritjen në detyrë*” nënkupton vendimin e Këshillit për ngritjen në detyrë të kandidatit të renditur më lart në një procedurë përzgjedhëse, pas kalimit të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Komisioni i Posaçëm i verifikimit të pasurisë dhe figurës.

y) “*Vendim për moscaktimin në detyrë*” nënkupton vendimin e Këshillit për moscaktimin në detyrë të kandidatëve, të cilët nuk kalojnë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës.

z) “*Vendim për ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë*” nënkupton vendimin e Këshillit, kur kandidati tërhiqet nga kandidimi, derisa nuk ka përfunduar procedura e ngritjes në detyrë;



Neni 5

Rregulla të përgjithshme për ngritjen në detyrë si prokuror i Posaçëm ose drejtues i Prokurorisë së Posaçme

1. Komisioni kryen një vlerësim fillestar të të gjithë kandidatëve për të përcaktuar nëse ata i plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme ose si drejtues të kësaj prokurorie.

2. Komisioni i propozon Këshillit kualifikimin e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet ligjore.

3. Këshilli kualifikon kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore dhe shpall listën zyrtare të kandidatëve që vijojnë procesin e vlerësimit të kriterëve.

4. Komisioni vijon me vlerësimin e kandidatëve, pasi cakton me short një ose disa relatorë për çdo kandidat. Komisioni ose relatori kërkojnë nga kandidati dhe institucionet publike çdo lloj dokumenti të rëndësishëm për vlerësim, si dhe kryen intervista me kandidatët.

5. Komisioni dhe relatori përdor dokumentet dhe letrat e motivimit për të bërë propozimet përkatëse për vlerësimin e kandidatëve për pozicionin e prokurorit të posaçëm, bazuar në:

a) vlerësimet e mëparshme profesionale; dhe

b) kriteret e posaçme etike dhe profesionale të parashikuara në nenin 18 të kësaj Rregulloreje.

6. Në çdo rast, për vlerësimin e shkallës së kualifikimit, në lidhje me kriterin e parashikuar në nenin 18, pika 1, të kandidatëve, Komisionit dhe/ose Këshilli merr parasysh edhe angazhimin personal dhe profesional të kandidatit si ekspert dhe përvojën specifike.

7. Në rast se pas vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale, ka kandidatë me pikë të barabarta, Këshilli i rendit kandidatët sipas vjetërsisë si magistrat ose jurist.

8. Komisioni i propozon Këshillit, për secilin kandidat dhe për secilin nga kriteret e parashikuara në nenin 18, të miratojë njërën nga shkallët e vlerësimit të parashikuar në nenin 21 të kësaj Rregulloreje.

9. Këshilli, pas miratimit të shkallës së vlerësimit, bën renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas nenit 34.

10. Shkalla e vlerësimit dhe renditja e kandidatëve miratohet me shumicën e votave të Këshillit.

11. Pas vlerësimit dhe përpara emërimit në detyrë, Këshilli i përcjell listën e kandidatëve të kualifikuar Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, i cili brenda 120 ditësh kryen verifikimet e përcaktuara në pikën 6, të nenit 6, të ligjit nr. 95/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, të ndryshuar.

12. Pas vlerësimit nga Komisioni i Posaçëm i verifikimit të pasurisë dhe figurës, Komisioni i propozon Këshillit, mosaktimin në detyrë të kandidatëve, të cilët marrin një vlerësim negativ.

13. Këshilli vendos ngritjen në detyrë të kandidatëve, pasi ata të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, si dhe atë të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

14. Në rast konflikti ndërmjet këtij neni dhe neneve, të cilat parashikojnë rregullime të posaçme për secilin hap të procedurës, neni me parashikime të posaçme ka përparësi.

KREU II

KUSHTET LIGJORE DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË PROKURORINË E POSAÇME

Neni 6

Kushtet ligjore për ngritjen në detyrë si prokuror i posaçëm

Kushtet ligjore që duhet të përmbushë prokurori që kandidon për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, janë:

1. Të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë.

2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Të ketë ushtruar funksionin si prokuror për jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

4. Të përmbushë kushtet e sigurisë, të parashikuara në nenin 6, të ligjit nr. 95/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, përfshirë edhe kushtin se duhet të ketë dorëzuar formularë të vlefshëm të shprehjes së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve personale, të nënshkruar prej kandidatit dhe anëtarëve të afërt të familjes.

5. Të ketë kaluar me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit.



6. Të mos jetë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 7

Shpallja e procedurës së ngritjes në detyrë

1. Këshilli organizon procedurën e ngritjes në detyrën e prokurorit ose të drejtuesit në Prokurorinë e Posaçme, për çdo vend që është i lirë ose pritet të bëhet i lirë.

2. Në rastin e mbarimit të mandatit të drejtuesit ose të një prokurori, procedura fillon të paktën 3 muaj përpara mbarimit të mandatit.

3. Me marrjen dijeni për vendin e lirë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i paraqet Këshillit relacionin përkatës, ku pasqyron vendet e lira, si dhe i propozon Këshillit shpalljen e vakancës dhe organizimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

4. Këshilli merr vendim për vendet për të cilat shpall procedurën e ngritjes në detyrë dhe njëkohësisht bën thirrje për paraqitjen e shprehjes së interesit.

5. Thirrja përmban informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit, sipas parashikimeve të nenit 7, të ligjit nr. 95/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, të ndryshuar.

6. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Këshillit dhe qëndron e hapur për një periudhë prej të paktën 2 (dy) javësh nga e nesërmja e shpalljes.

7. Afati për paraqitjen e shprehjes së interesit mund të zgjatet, kur është e nevojshme, me vendim të arsyetuar të Këshillit.

Neni 8

Dokumentacioni i nevojshëm për kandidim

1. Prokurorët e interesuar shprehin interesin për kandidim nëpërmjet një kërke, së cilës i bashkëlidhin dokumentacionin e kërkuar nga Këshilli në thirrjen për ngritjen në detyrë, formularët e vetë deklarimit, si dhe kopje të çdo dokumentacioni provues për aftësitë dhe kualifikimet e kandidatit që nuk gjenden në dosjen personale.

2. Krahës kërkesës për kandidim, kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Një letër motivimi, (jo më shumë se 3 faqe format A4,) ku tregojnë arritjet e tyre më të spikatura në hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe arsyet e kandidimit;

b) Një CV (*Curriculum Vitae*) të përditësuar;

c) Formularët e parashikuar në shtojcat B1 dhe B3 të ligjit nr. 95/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, të plotësuar rregullisht;

d) Çdo dokumentacion që lidhet me kriteret e vlerësimit sipas përcaktimeve të nenit 4, geramat, *“m”, “n”, “o”, “p”, “q”, “r”, “s”*; të kësaj Rregulloreje, si dhe çdo dokumentacion tjetër që kandidati vlerëson.

e) Kopje të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo Kolegjit të Apelimit, që provon se kandidati për prokuror në Prokurorinë e Posaçme ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar;

3. Komisioni ose relatori kërkon nga kandidati të paraqesë listën me çështjet për 5 vjetët e fundit, për të cilat është vendosur pafajësi me të pandehur në gjendje arresti, është vendosur pushimi me të pandehur të arrestuar, si dhe me çështjet e transferuara për kompetencë. Komisioni ose relatori në çdo moment mund të kërkojë dokumentacion shtesë ose sqarime nga kandidatët, kur vlerëson se ai është i nevojshëm për procedurën e konkurrimit.

Neni 9

Të drejtat e kandidatit

1. Kandidati njoftohet për relatorin jo më vonë se 3 (tre) ditë nga caktimi i tij.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 174, të ligjit për qeverisjen, jo më vonë se 3 (tre) ditë, nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit. Kërkesa shoqërohet, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtar tjetër të Këshillit.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e saj.

4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së ngritjes në detyrë, të kërkojë të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.



5. Kandidati ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për ngritje në detyrën e prokurorit ose të drejtuesit në Prokurorinë e Posaçme, të kërkojë kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të ligjit për statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në këtë rast, kandidati duhet të ketë ushtruar detyrën përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, si dhe të mos jetë vlerësuar për dy vjetët e fundit kalendarikë. Procedura e përshpejtuar e vlerësimit të prokurorit kandidat bëhet pjesë e procedurës së ngritjes në detyrën e drejtuesit ose të prokurorit në Prokurorinë e Posaçme që zhvillon Këshilli.

6. Kandidati i komanduar, të cilit, gjatë apo në përfundim të komandimit, nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni ku ai është komanduar, ka të drejtë që në momentin e kandidimit për ngritje në detyrën e drejtuesit ose prokurorit në Prokurorinë e Posaçme, të kërkojë të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidati jo gjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit për statusin. Në këtë rast, periudha e komandimit duhet të ketë zgjatur jo më pak se një vit kalendarik.

7. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Këshillit, Komisionit ose të relatorit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kushtet ligjore të kandidimit dhe/ose kriteret e renditjes, si dhe të depozitojë, kur është rasti, dokumente shpresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e ngritjes në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të Komisionit, Këshilli vendos ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin që është paraqitur kërkesa e tërheqjes nga kandidimi. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare.

Neni 10 Afatet

1. Afatet në procedurën e ngritjes në detyrën e prokurorit ose të drejtuesit në Prokurorinë e Posaçme caktohen në ditë, në javë ose në muaj. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.

2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në javë mbaron me kalimin e asaj dite, që është e njëjta me ditën, në të cilën ka ndodhur ngjarja, nga e cila ka filluar të ecë afati.

4. Afati i përcaktuar në muaj mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

5. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

6. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24:00, përveç rastit kur në vendimin e Këshillit për shpalljen e procedurës së ngritjes në detyrë, parashikohet ndryshe.

Neni 11 Njoftimet

1. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit, Komisionit ose relatorit, drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.

2. Adresa elektronike e Këshillit ose e Komisionit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së ngritjes në detyrën e prokurorit ose të drejtuesit në Prokurorinë e Posaçme.

3. Adresë elektronike e kandidatit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit. Kandidati merr masa dhe është përgjegjës për funksionimin e vazhdueshëm të adresës së tij elektronike.

Neni 12 Konflikti i interesave

1. Anëtari i Komisionit ose i Këshillit, që ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, sipas neneve 171 deri 175 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave



në ushtrimin e funksioneve publike”, heq dorë nga procesi i vlerësimit, renditjes dhe votimit të kandidatëve.

2. Në këtë rast, detyrat e anëtarit të Komisionit ushtrohen nga anëtari zëvendësues, i cili caktohet me short.

Neni 13

Hedhja e shortit

1. Për trajtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, hidhet shorti mes anëtarëve të Komisionit.

2. Secili anëtar i Komisionit trajton dhe vlerëson si relator një numër afërsisht të barabartë kandidatësh me anëtarët e tjerë.

3. Shorti hidhet në prani të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe monitoruesve ndërkombëtarë.

4. Secili anëtar i Komisionit, sipas rendit alfabetik, tërheq fletët e mbyllura ku janë shënuar emrat e kandidatëve.

5. Pas tërheqjes së çdo flete, anëtari i Komisionit e hap atë dhe lexon emrin e kandidatit që do të vlerësojë.

6. Në përfundim të procesit lexohen emrat e kandidatëve që do të vlerësojë secili anëtar i Komisionit.

7. Kur janë më pak kandidatë se anëtarë Komisioni, mund të ketë më shumë se një relator për çdo kandidat.

8. Për hedhjen e shortit mbahet procesverbali përkatës.

Neni 14

Tërheqja dhe dorëzimi i dokumentacionit

1. Secili anëtar i Komisionit tërheq pranë zyrës së protokollit të Këshillit, kopje të dokumentacionit të kandidatëve që do të vlerësojë sipas shortit.

2. Tërheqja e dokumentacionit bëhet kundrejt nënshkrimit, me një procesverbal të veçantë dhe nën përgjegjësinë e anëtarit të Komisionit.

3. Në përfundim të procesit të vlerësimit nga ana e Komisionit, anëtarët e Komisionit dorëzojnë dokumentacionin e marrë sërish me një procesverbal të veçantë.

Neni 15

Dokumentimi i punës së Komisionit

1. Komisioni asistohet nga këshilltarët ligjorë të Këshillit, të caktuar nga kryetari i Komisionit të Posaçëm.

Faqe | 15910

2. Këshilltarët ligjorë mbajnë procesverbalin e mbledhjeve i cili, pas zbardhjes, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm. Këshilltarët ndihmojnë anëtarët e Komisionit gjatë të gjithë procedurës.

3. Mbledhjet e Komisionit dokumentohen për aq sa është e mundur edhe nëpërmjet regjistrimit audiovizual sipas parashikimeve të nenit 168, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

4. Në përfundim të procesit të vlerësimit, dokumentacioni i mbledhjeve të Komisionit dorëzohet dhe ruhet në arkivin e Këshillit.

KREU III

KRITERET DHE MËNYRA E VLERËSIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË PROKURORINË E POSAÇME

Neni 16

Kriteri i vlerësimit të performancës

Kriteri i vlerësimit të performancës së kandidatëve përfshin dy vlerësime të fundit të performancës së kandidatit.

Neni 17

Vlerësimi i kriterit të performancës

1. Shkallët e vlerësimit të kriterit të performancës së kandidatit, bazuar në rezultatet e tyre në dy vlerësime të fundit profesionale, të parashikuara në nenin 16 dhe që pasqyrohen në formularin nr. 2, janë si më poshtë:

<i>Niveli i vlerësimit</i>	<i>Pikët</i>
Shkëlqyeshëm	3.5
Shumë mirë	2.5
Mirë	1.5
Mjaftueshëm	0.5

2. Niveli i vlerësimit të kriterit të performancës, shpreh shumën e pikëve për dy vlerësime të fundit etiko-profesionale të kandidatit.

Neni 18

Kriteret e posaçme etike dhe profesionale për ngritjen në detyrë si prokuror i posaçëm

Kriteret e posaçme etike dhe profesionale për ngritjen në detyrë si prokuror i posaçëm janë:



1. Aftësitë e treguara:

a) në hetim,

i. përfshirë përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit;

ii. qasjen proaktive të hetimi.

b) në ndjekjen penale, përfshirë formulimin e akuzës dhe përfaqësimin në gjykatë;

c) në konfiskimin e produkteve të veprës penale dhe të aseteve,

i. sipas Kodit të Procedurës Penale;

ii. ligjit antimafia.

2. Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti i posaçëm profesional,

a) përfshi etikën profesionale;

b) ndershmërinë;

c) paanësinë;

d) sigurinë;

e) konfidencialitetin e treguar nga kandidati.

Neni 19

Aktet që merren në shqyrtim nga Komisioni

1. Për vlerësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 18, të kësaj Rregulloreje, Komisioni shqyrton aktet procedurale të kandidatit në çështjet e paraqitura dhe aktet respektive të gjykatës, për të përcaktuar nëse produkti i punës së tij/saj është ligjërish i plotë, i saktë në fakte, i organizuar dhe i paraqitur mirë. Komisioni vlerëson në mënyrë të posaçme ato tipare të punës së kandidatëve, që janë thelbësore dhe të lidhura me aftësitë e treguara në hetim, përdorimin e teknikave të posaçme, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjykatë dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale sipas Kodit të Procedurës Penale dhe të aseteve sipas ligjit antimafia. Komisioni shqyrton, gjithashtu, edhe çdo çështje tjetër të hetuar nga kandidati gjatë karrierës së tij, e cila ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

2. Për vlerësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 18, të kësaj Rregulloreje, kandidatët i paraqesin Komisionit:

a) situatat/rrethanat ku ata kanë kapërcyer vështirësi të spikatura ose i kanë bërë ballë presionit gjatë një hetimi ose ndjekjeje penale, duke bërë të mundur dërgimin e çështjes në gjyq. Kandidati përshkruan qartë vështirësitë dhe veprimet e kryera prej tij, të cilat kanë kontribuar në suksesin e hetimit ose të ndjekjes penale.

b) situatat/rrethanat ku ata kanë treguar etikë të lartë profesionale, duke ruajtur paanësinë, ndershmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave hetimore pavarësisht vështirësive të spikatura me të cilat janë përballur. Komisioni, për vlerësimin e këtij kriteri, bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, ku përshkruhen çështje, situata, rrethana që dëshmojnë vendosmërinë në përballimin e vështirësive, presioneve dhe rreziqeve, si dhe integritetin e posaçëm profesional. Komisioni shqyrton kryesisht edhe çdo çështje tjetër të hetuar nga kandidati gjatë karrierës së tij, e cila nga ana e Komisionit shërben për të vlerësuar kandidatin për kriterin e vendosmërisë dhe integritetit.

Neni 20

Mënyra e vlerësimit për kriteret e posaçme etike dhe profesionale

1. Kandidatët vlerësohen për kriterin e pikës 1, të nenit 18, sipas këtyre elementeve: përdorimi i teknikave të posaçme të hetimit, qasja proaktive dhe aftësitë në ndjekjen penale, përfshirë formulimin e akuzës dhe përfaqësimin në gjykatë.

2. Elementet e vlerësimit për kriterin e pikës 1, të nenit 18, nuk janë kumulative.

3. Secili prej elementeve të vlerësimit për kriterin e germës “a”, të nenit 18, hartohet mbi bazën e përkufizimeve të parashikuara në nenin 4 të Rregullores.

4. Vlerësimi për çdo element bazohet në numrin e çështjeve për të cilat kandidati ka dorëzuar akte procedurale të dosjeve (*vlerësim sasior*) dhe veçanërisht në përmbajtjen e këtyre akteve në raport me kriteret e vendosura (*vlerësim cilësor*).

5. Nëse verifikohet angazhimi i kandidatit si ekspert apo përvojë specifike, sipas përcaktimit të nenit 4, gërmat “n” dhe “m”, kandidati përfiton rritje me 1 (*një*) nivel të shkallës së vlerësimit për kriterin e përcaktuar në nenin 18, pika 1.

6. Këshilli dhe/ose Komisioni, referuar kriterit të përcaktuar në nenin 18, pika 2, vlerëson rast pas rasti rrethanat e paraqitura nga vetë kandidati ose të evidentuara kryesisht.



Neni 21

Pikëzimi sipas shkallëve të vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale

1. Shkallët e vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale pikëzohen si më poshtë:

- a) **“Kualifikim i lartë”** vlerësohet me 8–10 pikë;
- b) **“Kualifikim i mesëm”** vlerësohet me 4–7 pikë;
- c) **“Kualifikimi i ulët”** vlerësohet me 1–3 pikë.

2. Në pikëzimin e secilit kriter, Këshilli merr parasysh edhe intervistën me secilin kandidat.

Neni 22

Kualifikimi i lartë në aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim

Kandidati vlerësohet me **“Kualifikim të lartë”** për këtë kriter kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:

a) ka hetuar me sukses jo më pak se pesë çështje penale të ndërlikuara ligjërisht ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;

b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore për të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

d) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive, të cilat janë produkte të veprës penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e lartë.

Neni 23

Kualifikimi i mesëm në aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim

Kandidati vlerësohet me **“Kualifikim të mesëm”** për këtë kriter, kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:

a) ka hetuar me sukses jo më pak se tri çështje penale të ndërlikuara ligjërisht ose në fakte përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive;

b) ka qenë drejtues grupi hetimor ose prokuror i vetëm dhe/ose ka përfaqësuar prokurorinë në nivel apeli/Gjykatë të Lartë, në jo më pak se pesë procese gjyqësore në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

c) ka qenë pjesë e një grupi prokurorësh, në shkallë të parë ose në nivel apeli, në jo më pak se dhjetë procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim dënimi për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose për çështje të tjera të ndërlikuara;

d) ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive që përbëjnë produkte të veprave penale në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë mesatare ose ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia, në jo më pak se pesë raste dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë mesatare.

Neni 24

Kualifikimi i ulët në aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim

Kandidati vlerësohet me **“Kualifikim të ulët”** për këtë kriter, kur verifikohet një nga faktet e mëposhtme:

a) ka hetuar me sukses të paktën një çështje penale të ndërlikuar ligjërisht ose në fakte, përfshi përdorimin e metodave të avancuara të hetimit dhe qasjen proaktive ose është përpjekur të hetojë çështje të ndërlikuara dhe të përdorë teknika të avancuara hetimi, por ka qenë i pasuksesshëm;

b) nuk ka marrë pjesë në procese gjyqësore, në të cilat është dhënë vendim për korrupsion, krim të organizuar, pastrim parash, ose çështje të tjera penale të ndërlikuara;

c) ka ndihmuar në të paktën një rast, një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive që përbëjnë produkte të veprave penale dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e ulët ose ka ndihmuar në të paktën një rast, një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar me sukses konfiskimin e pasurive në zbatim të ligjit antimafia dhe/ose kur vlera e aseteve të konfiskuara ka qenë e ulët.



Neni 25

Shkallët e vlerësimit të kriterit të vendosmërisë dhe integritetit

1. Komisioni shqyrton aktet procedurale të kandidatit, duke përfshirë edhe ato të parashikuara në pikën 3, të nenit 8 të kësaj Rregulloreje, si dhe aktet respektive të gjykatës për të vërtetuar vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit. Komisioni vlerëson në mënyrë të posaçme ato tipare të punës së kandidatëve që janë thelbësore dhe të lidhura me vendosmërinë e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve.

2. Komisioni i vlerëson kandidatët në varësi të sasisë dhe cilësisë së situatave/rrethanave që kanë vënë në provë vendosmërinë dhe integritetin e kandidatit, bazuar në aktet e administruara, sipas pikës 2, të nenit 19, të kësaj Rregulloreje:

a) **“Kualifikim të lartë”**, nëse verifikohen dhe vlerësohen raste të cilat tregojnë nivel të lart integriteti.

b) **“Kualifikim të mesëm”**, nëse nuk ka dokumente provuese të cilat provojnë kualifikim të ulët ose të lartë.

c) **“Kualifikim të ulët”**, nëse verifikohen dhe vlerësohen raste të cilat tregojnë nivel të ulët integriteti.

KREU IV

PROCESI I VLERËSIMIT

Neni 26

Komisioni i Posaçëm

1. Për vlerësimin paraprak të kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, Këshilli, për çdo procedurë, krijon një Komision të Posaçëm të veçantë;

2. Komisioni ngrihet me vendim të Këshillit menjëherë mbas shpalljes së vendeve vakante për prokuror ose për drejtues në Prokurorinë e Posaçme.

3. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prej të cilëve 3 anëtarë prokurorë dhe 2 anëtarë joprokurorë. Anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë *ex officio* anëtarë të Komisionit të Posaçëm. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale *përfshihen ex officio* nga pjesëmarrja në Komisionin e Posaçëm. Dy anëtarët e tjerë të

Komisionit të Posaçëm, njëri prej të cilëve anëtar prokuror dhe tjetri anëtar jo prokuror, zgjidhen me short nga pjesa e mbetur e anëtarëve të Këshillit.

4. Kryetari i Këshillit cakton kryetarin e Komisionit të Posaçëm;

5. Komisioni i Posaçëm kryen të gjitha detyrat e ngarkuara nga ligji dhe nga kjo Rregullore, në lidhje me procedurën e ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Posaçme;

Neni 27

Shqyrtimi fillestar

1. Brenda 7 (*shtatë*) ditëve nga mbarimi i afatit të shpalljes, Komisioni kryen verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për ngritjen në detyrë.

2. Kryetari i Komisionit raporton në mbledhjen e radhës së Këshillit, e cila mbahet sa më shpejt të jetë e mundur, emrat e kandidatëve të cilët vlerësohet se përmbushin kushtet ligjore.

3. Këshilli miraton listën me emrat e kandidatëve, që plotësojnë kushtet ligjore, sipas rendit alfabetik.

4. Komisioni verifikon statusin e kandidatit në procesin e rivlerësimit kalimtar të kandidatit, sipas ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, pranë zyrës së burimeve njerëzore, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Neni 28

Afatet lidhur me procedurën e vlerësimit të kriterëve ligjore

1. Pas plotësimit të kushteve ligjore, Komisioni kërkon nga kandidatët të identifikojnë produktin e punës së tyre dhe çështjet që mbështesin aplikimin e tyre, në përputhje me kriteret e renditura në nenet 21, 22 dhe 23. Kandidatët kanë 14 (*katërmëdhjetë*) ditë afat për të identifikuar këto dokumente dhe për t'i vënë në dispozicion të Komisionit.

2. Komisioni përfundon vlerësimin e kandidatëve sipas shkallëve të përcaktuara në nenin 21 të kësaj Rregulloreje, brenda 6 javëve nga paraqitja e dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni dhe i dërgon Këshillit raportin përfundimtar, si dhe gjithë dokumentacionin mbështetës.

3. Këshilli realizon intervistat me kandidatët brenda 14 (*katërmëdhjetë*) ditëve nga dërgimi i raportit përfundimtar të Komisionit dhe jo më parë se Këshilli të ketë marrë vendim për shkallët e vlerësimit të secilit kriter. Intervistat me kandidatët



regjistrohen me audio dhe me video. Këshilli mund të kërkojë prej kandidatëve ose prej institucioneve publike informacione shtesë, të cilat e ndihmojnë në vlerësimin e kandidatit.

4. Këshilli bën vlerësimin përfundimtar dhe renditjen e kandidatëve jo më vonë se 1 javë nga përfundimi i procesit të intervistimit të kandidatëve.

Neni 29

Procesi i vlerësimit në Komision

1. Pasi Këshilli përcakton kandidatët që përmbushin kushtet ligjore sipas nenit 6, Komisioni i vlerëson ata sipas kriterëve të parashikuara në nenet 16 dhe 18 të kësaj Rregulloreje dhe sipas shkallëve të vlerësimit të parashikuara në nenet 17 dhe 20 të kësaj Rregulloreje.

2. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë të gjitha dokumentet e kandidatit dhe standardet e renditura në kreun III. Këto standarde përfshijnë aplikimin e kandidatit, vlerësimet e mëparshme të kandidatit, produktet e mëparshme të punës, deklaratat e motivimit ose dokumente të tjera të bashkëngjitura ose të kërkuara në institucione të ndryshme.

3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, secili nga anëtarët e Komisionit kryen një vlerësim paraprak.

4. Vlerësimi paraprak i çdo anëtari për kandidatët, sipas shortit, diskutohet me anëtarët e tjerë të Komisionit.

5. Çdo anëtar i Komisionit, pasi është njohur me vlerësimin paraprak të një anëtari tjetër, ka të drejtë të kërkojë të njihet me aktet e dosjeve të kandidatëve përkatës.

6. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të bëjë pyetje, vërejtje dhe të paraqesë propozime konkrete lidhur me shkallën e vlerësimit të kandidatëve.

7. Pas shqyrtimit të të gjitha vlerësimeve paraprake të përgatitura nga anëtarët e Komisionit, kryetari i Komisionit hap procedurën e votimit.

8. Komisioni vendos shkallën e vlerësimit të secilit kriter për secilin kandidat me shumicë të thjeshtë dhe ia propozon Këshillit, sipas formularit nr. 1 të kësaj Rregulloreje. Anëtari/anëtarët e mbetur në pakicë në Komision mund t'i propozojnë dhe argumentojnë Këshillit një shkallë të ndryshme vlerësimi.

9. Anëtarët e Komisionit arsyetojnë për shkallën e propozuar të vlerësimit dhe përshkruajnë faktet

mbi të cilat mbështesin arsyetimin. Propozimit i bashkëlidhen të gjitha dokumentet mbështetëse.

Neni 30

Raportimi në Këshill

1. Kur Komisioni përfundon vlerësimet e tij, kryetari i Komisionit njofton kryetarin e Këshillit, i cili thërret sa më shpejt mbledhjen plenare të Këshillit. Kryetari i Komisionit vendos në dispozicion të anëtarëve të Këshillit kopje të vlerësimeve të shkruara, raporteve individuale për çdo kandidat, dokumentet mbështetëse dhe raportin përfundimtar.

2. Gjatë mbledhjes së hapur, kryetari i Komisionit prezanton për anëtarët një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit.

Neni 31

Vlerësimi në Këshill

1. Këshilli, bazuar në propozimin e Komisionit, vendos shkallën e vlerësimit për secilin kandidat dhe për secilin kriter.

2. Këshilli mund të ndryshojë shkallën e vlerësimit të propozuar nga Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 32

Intervista

Anëtarët e Këshillit, gjatë intervistës i drejtojnë pyetje me karakter të përgjithshëm dhe profesional secilit kandidat, në funksion të pikëzimit sipas shkallëve të vlerësimit të kriterëve të posaçme etike dhe profesionale.

Neni 33

Renditja e kandidatëve

1. Mbas përfundimit të procedurës së intervistimit, Këshilli, duke u bazuar te kjo e fundit dhe te shkallët e vlerësimit të miratuara më parë, bën renditjen e kandidatëve.

2. Çdo anëtar i Këshillit vendos pikët për secilin prej kriterëve, brenda hapësirës së pikëzimit të caktuar për atë shkallë vlerësimi në përputhje me nenin 20 të kësaj Rregulloreje, duke plotësuar formularin nr. 3 të kësaj Rregulloreje.



3. Në përfundim të procesit të pikëzimit, kandidatët renditen sipas numrit të pikëve në përputhje me tabelën në formularët nr. 4 dhe nr. 5 të kësaj Rregulloreje.

4. Në përfundim të votimit kryetari deklaron rezultatin e votimit.

Neni 34

Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe e drejta e ankimit

1. Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve arsyetohet nga relatori jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga miratimi i tij. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në votim.

2. Vendimi i arsyetuar i Këshillit iu njoftohet kandidatëve.

3. Kundër vendimit të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

4. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

5. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

Neni 35

Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve

1. Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve i dërgohet Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës pranë Prokurorisë së Posaçme.

2. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, kryen verifikimet për kandidatët dhe i dërgon Këshillit një Raport të detajuar mbi pasurinë dhe figurën e kandidatëve.

3. Komisioni i Posaçëm pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pasi shqyrton raportin, i propozon Këshillit mosçaktivimin në detyrë të kandidatëve të cilët nuk kalojnë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës.

4. Vendimi i Këshillit për mosçaktivimin në detyrë është i formës së prerë.

Neni 36

Vendimi i ngritjes në detyrë

1. Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, 7 (shtatë) ditë pas përmbylljes së procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës mbi bazën e vendimit për renditjen e kandidatëve.

2. Vendim i Këshillit i njoftohet prokurorit të ngritur në detyrë, prokurorive respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

3. Një kopje e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të prokurorit të ngritur në detyrë.

Neni 37

Zgjedhja e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme

1. Këshilli 3 (tre) muaj përpara mbarimit të mandatit të drejtuesit, shpall thirrjen për kandidim nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, që nuk e kanë mbajtur më parë këtë detyrë.

2. Kandidatët e interesuar paraqesin motivimin e tyre, si dhe një platformë për drejtimin e Prokurorisë së Posaçme, të cilat do të vlerësohen nga ana e Këshillit.

3. Platforma, ndër të tjera, duhet të përmbajë dhe të shoqërohet sipas rastit nga dokumentacioni që provon:

a) eksperiencën në ndjekjen e çështjeve sensitive të korrupsionit dhe të krimit të organizuar;

b) eksperiencën dhe aftësitë në organizimin dhe në drejtimin e një strukture;

c) eksperiencën në hartimin e miratimin e rregulloreve administrative;

d) eksperiencën në çështje të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike dhe ndërveprim me medien;

e) aftësitë në drejtimin efektiv të burimeve njerëzore;

f) vizionin ose planin e besueshëm për organizimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv;

g) imazhin publik të karrierës së tij/saj si prokuror.



4. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës bën verifikimin e kushteve të kandidimit të secilit prej kandidatëve, si më poshtë:

a) është prokuror i Prokurorisë së Posaçme në momentin e kandidimit;

b) nuk ka mbajtur më parë detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme,

c) ka aplikuar brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e Këshillit;

d) nuk ka masë disiplinore në fuqi.

5. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës jo më vonë se 10 ditë nga mbyllja e afatit të kandidimit, paraqet për miratim në mbledhje plenare, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e kandidimit.

6. Nëse asnjëri prej prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme nuk shfaq interes për pozicionin e drejtuesit, nuk plotësojnë kushtet e kandidimit ose procedura mbyllet për arsye të tjera pa një vendim përfundimtar, Këshilli cakton përkohësisht në këtë detyrë njërin nga prokurorët e prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur kriteret e mësipërme.

Neni 38

Procedura e zgjedhjes së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme

1. Këshilli fton çdo prokuror të Prokurorisë së Posaçme, që ka shprehur interesin për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për të paraqitur para Këshillit në një prezantim të shkurtër secilin prej kriterëve të renditura në nenin 38.

2. Votimi për drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme bëhet i hapur dhe nominal.

3. Secili anëtar i Këshillit nuk mund të votojë për më shumë se një kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

4. Drejtues i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet kandidati që merr më shumë vota në Këshill.

5. Në rast se dy a më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, Këshilli me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të pranishëm, kryen një votim të dytë mes kandidatëve me numër të barabartë votash.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

Komunikimet jozyrtare gjatë procesit të zgjedhjes

Ndalohen komunikimet jozyrtare mes një anëtari të Komisionit Këshillit dhe një kandidati për prokuror në Prokurorinë e Posaçme nga fillimi e deri në përfundim të shpalljes së rezultateve.

Neni 40

Monitoruesit e procesit të vlerësimit

Përfaqësues të misionit ndërkombëtar OPDAT mund të jenë pjesëmarrës në procesin e intervistave dhe faza të tjera të vlerësimit të kandidatëve. Ata mund të drejtojnë pyetje gjatë intervistave, pasi të kenë përfunduar anëtarët e Këshillit.

Neni 41

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Procedurat e parashikuara në këtë Rregullore kryhen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar.

2. Dokumentet duhet të jenë të redaktuara para publikimit, në rast se përmbajnë informacion personal të kandidatëve ose informacion rreth personave të tjerë.

3. Në rast se përhapja e informacionit apo dokumenteve cenon informacionin e klasifikuar sekret apo sigurinë publike, atëherë Komisioni i Posaçëm ose Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, nuk i përfshijnë në dosjen e kandidatit, si dhe nuk i njofton ato.

Neni 42

Përfundimi i procedurës pa një vendim përfundimtar

Këshilli vendos përfundimin e një procedure pa një vendim përfundimtar në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk është paraqitur asnjë kërkesë për atë procedurë, brenda afatit të caktuar;



- b) kur në vijim të procedurës së ngritjes në detyrë, nuk mbetet asnjë kandidat në atë procedurë;
c) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Neni 43

Rregulla në lidhje me vlerësimet e mëparshme

1. Për zbatimin e kriterëve të renditjes së kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, sipas vlerësimeve etike dhe profesionale, si rregull, konsiderohen vlerësimet e bëra, sipas ligjit për statusin. Vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale të kandidatit të realizuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, si dhe vlerësimet e prokurorëve të komanduar, konsiderohen të vlefshme për efekt të kësaj Rregulloreje dhe konvertohen si më poshtë:

<i>Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vjetër të vlerësimit etik dhe profesional ose për prokurorin e komanduar</i>	<i>Konvertimi i nivelit të vlerësimit sipas shkallëve të vlerësimit aktual të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin"</i>
Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Mirë	Mirë
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

Neni 44

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Rregullorja e miratuar me vendimin nr. 51, datë 19.3.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", shfuqizohet.

VLERËSIMI INDIVIDUAL NGA KOMISIONI SIPAS SHKALLËVE, TË KANDIDATËVE PËR PROKURORINË E POSAÇME

Formulari nr. 1

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE					
		Ndjekja penale, hetimi, teknikat, përfaqësimi, konfiskimi			Vendosmëria dhe Integriteti		
		Ulët	Mesëm	Lartë	Ulët	Mesëm	Lartë
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

KOMISIONI I POSAÇËM

(_____)



VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Formulari nr. 2

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	Viti paraardhës				Viti i fundit				TOTALI
		Mjaftueshëm 0.5 pikë	Mirë 1.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	Shkëlqyeshëm 3.5 pikë	Mjaftueshëm 0.5 pikë	Mirë 1.5 pikë	Shumë mirë 2.5 pikë	Shkëlqyeshëm 3.5 pikë	
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										

VLERËSIMI INDIVIDUAL I SECILIT ANËTAR TË KËSHILLIT PËR ÇDO KANDIDAT

Formulari nr. 3

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	VLERËSIMI I AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE						TOTALI
		Ndjekja penale, hetimi, teknikat, përfaqësimi, konfiskimi			Vendosmëria dhe Integriteti			
		Ulët 1-3	Mesëm 4-7	Lartë 8-10	Ulët 1-3	Mesëm 4-7	Lartë 8-10	
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

ANËTAR I KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË



VLERËSIMI TOTAL I SECILIT ANËTAR TË KËSHILLIT PËR ÇDO KANDIDAT

Formulari nr. 4

Nr.	Emri e mbiemri kandidatit	VLERËSIMI ME PIKË I ANËTARËVE TË KËSHILLIT											Performanca	TOTALI
		Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar		
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

RENDITJA E KANDIDATËVE PËR PROKURORINË E POSAÇME

Formulari nr. 5

Nr.	Emri e mbiemri i kandidatit	Pikë në total
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

**VENDIM**
Nr. 304, datë 19.9.2023**Neni 1**
Objekti**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES**
“PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE MBI ULJEN E
NGARKESËS SË PUNËS PËR
PROKURORËT”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “c” të Kushtetutës, nenin 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 26, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të grupit të punës, të ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 180, datë 30.12.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët’”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për caktimin e rregullave dhe procedurave mbi uljen e ngarkesës së punës për prokurorët”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.

3. U shpall në Tiranë, sot më 19.9.2023.

KRYETAR
Alfred Balla

RREGULLORE
PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE MBI ULJEN E
NGARKESËS SË PUNËS PËR
PROKURORËT

Në mbështetje të nenit 149/a, pika 1, germa “c” të Kushtetutës, nenit 26, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, hartohet dhe miratohet rregullorja si më poshtë:

Faqe | 15920

Ky akt përcakton rregulla të detajuara për procedurën që ndiqet për uljen e ngarkesës së çështjeve për prokurorët në rast nevojë, mënyrën e miratimit ose refuzimit të këtyre kërkesave, si dhe përlogaritjen e pagës dhe përfitimeve sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 2
Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të plotësoj kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për uljen e ngarkesës të punës së prokurorëve, duke respektuar parimin e barazisë dhe proporcionalitetit për të gjithë prokurorët.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë magistratët prokurorë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ditë” nënkupton ditët kalendarike me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune;

b) “Këshilli” nënkupton Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

c) “Komision” nënkupton Komisionin e Planifikimit Strategjik, të Administrimit dhe Buxhetit;

ç) “Kryetar i prokurorisë” nënkupton drejtuesin e çdo prokurorie, përfshirë Prokurorinë e Posaçme;

d) “Ligji për statusin” nënkupton ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

dh) “Ngarkesa” nënkupton numrin e çështjeve që duhet të trajtojë çdo prokuror brenda vitit, sipas normës së punës në fuqi të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Deri në përcaktimin e normës së punës, termi “ngarkesë” nënkupton mesataren e



numrit të përgjithshëm të çështjeve në atë prokurori ku paraqitet kërkesa;

e) “Ulje e ngarkesës” nënkupton reduktimin e numrit të çështjeve në ngarkim të magjistratit, për periudhën që kërkohet;

ë) “Kohë e reduktuar” nënkupton reduktimin e kohës ditore të punës për shkak të uljes së ngarkesës në punë.

Neni 5

Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues

1. Prokurori, i cili është i interesuar t'i ulët ngarkesa në punë, paraqet kërkesë me shkrim pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë vetëm për shkaqet si vijon:

a) për arsye të përkohshme shëndetësore të tij, të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindërve, gjyshërve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë nën kujdestari të kërkuesit, që shkaktojnë pamundësi për të ushtruar detyrën e prokurorit me ngarkesë të plotë dhe me kohë të plotë, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni përkatës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në një vit;

b) studime jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet, të vërtetuar me dokumentin përkatës të fitimit të së drejtës së studimit;

c) në rast angazhimi për shkak të funksionit të magjistratit edhe në detyra të tjera, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

2. Kërkesa e magjistratit për ulje të ngarkesës duhet të jetë e detajuar dhe të shoqërohet me dokumentet si vijon:

a) dokumentacion provues për arsyen e parashtruar në kërkesë;

b) deklaratën e subjektit kërkues nëpërmjet së cilës pranohet ulja e pagës në rast të miratimit të kërkesës, në masën e parashikuar në këtë rregullore;

c) informacion mbi numrin e çështjeve që prokurori ka në shqyrtim në momentin e paraqitjes së kërkesës;

ç) vërtetim kur është rasti, nga kryetari i prokurorisë ku ushtron funksionin, për mesataren e ngarkesës në atë prokurori;

d) informacion nga kryetari i prokurorisë për ngarkesën dhe rendimentin e magjistratit që ka paraqitur kërkesën, si dhe kur është rasti ngarkesën

mesatare dhe rendimentin e prokurorisë ku magjistrati ushtron detyrën;

dh) vërtetim nga kryetari i prokurorisë në atë prokurori ku është paraqitur kërkesa në qoftë se prokurori ka përfutur dhe më parë “ulje në ngarkesë”;

e) mendimin e kryetarit të prokurorisë nëse ulja e ngarkesës cenon interesat thelbësore të funksionit të prokurorit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente në prokurorinë përkatëse.

Neni 6

Shqyrtimi i kërkesës për uljen e ngarkesës

1. Kërkesa e paraqitur nga magjistrati së bashku me dokumentacionin shoqërues shqyrtohen nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, brenda 5 (pesë) ditësh nga paraqitja.

2. Kryetari i Komisionit organizon shortin për caktimin e relatorit, i cili pasi të shqyrtoj kërkesën do të përgatisë relacionin përkatës.

3. Relatori i ngarkuar për shqyrtimin e dosjes, nëse e sheh të nevojshme, mund të kërkojë dokumentacion shtesë, lidhur me rrethanat e paraqitura në kërkesë.

4. Në marrjen e vendimit Komisioni duhet të mbajë në konsideratë veçanërisht arsyen për të cilën kërkohet ulja e ngarkesës në punë nga magjistrati, performancën e tij në punë, si dhe vështirësitë që mund të shkaktohen në prokurorinë përkatëse si pasojë e miratimit të kërkesës.

5. Brenda dy javëve nga miratimi i relacionit në Komision, kërkesa merret në shqyrtim nga Këshilli në seancë plenare.

6. Këshilli mund të vendosë miratimin e kërkesës për uljen e ngarkesës në punë, në rastet kur:

a) sipas parashikimit të nenit 5, pika 1, germa “a”, të kësaj rregullore, Këshilli vlerëson se nuk cenohen interesat thelbësore të funksionit, afatet dhe ushtrimi në mënyrë eficiente të funksionimit të prokurorisë përkatëse;

b) sipas parashikimit të nenit 5, pika 1, germa “b”, të kësaj rregullore, Këshilli vlerëson njëkohësisht se studimet kanë si qëllim të rrisin aftësitë profesionale të magjistratit dhe nuk cenohen interesat thelbësore të funksionit, afatet dhe ushtrimi në mënyrë eficiente të funksionimit të prokurorisë përkatëse.

7. Vendimi për uljen e ngarkesës merret me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.



Neni 7

Masa e uljes së ngarkesës

1. Masa e uljes së ngarkesës, sipas rasteve të përcaktuara në nenin 5, pika 1, të kësaj rregulloreje, mund të ulet deri në 75 për qind të ngarkesës, në varësi të rrethanave.

2. Ulja e ngarkesës në punë shoqërohet me reduktimin e kohës së punës, në raport me masën e uljes së ngarkesës në punë.

Neni 8

Ulja e pagës dhe përfitimeve

Miratimi i kërkesës për uljen e ngarkesës në punë të prokurorit mund shoqërohet me ulje të pagës dhe përfitimeve të tjera, në masën jo më shumë se 75 për qind.

Neni 9

Refuzimi i kërkesës

Këshilli refuzon kërkesën në rastet, kur:

- a) nuk rezultojnë shkaqe të arsyeshme që legjitimojnë kërkesën;
- b) prokurori është subjekt i procedimit penal ose disiplinor;
- c) prokurori ka masë disiplinore në fuqi që lidhet me moskryerjen në kohë të detyrës;
- c) ulja e ngarkesës cenon interesat thelbësore të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve në prokurorinë përkatëse;
- d) vlerësohet se studimet nuk lidhen me objektin e veprimtarisë së funksionit të prokurorit.

Neni 10

Dispozita kalimtare

1. Kërkesat e miratuara përpara miratimit të kësaj rregulloreje do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në mbarim të afatit për të cilin janë lëshuar.

2. Në çdo rast, prokurorët që kanë përfituar ulje të ngarkesës para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, brenda një muaji nga hyrja në fuqi i venë në dispozicion Këshillit dokumentacionin provues, sipas kërkesave të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 305, datë 19.9.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI DHËNIEN E LEJES SË
PAPAGUAR”**

Bazuar në nenin 149 të Kushtetutës; nenet 160, 189 dhe 190, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; nenin 24, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 96, 132 dhe 132/1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 2, germa “c”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të grupit të punës të ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 56, datë 9.3.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për ‘Dhënie e lejes së papaguar’”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi dhënie e lejes së papaguar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.

3. U shpall në Tiranë, sot më 19.9.2023.

**KRYETAR
Alfred Balla**

**RREGULLORE****MBI DHËNIEN E LEJEVE TË PAPAGUARA****Neni 1****Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregulla më të hollësishme lidhur me:

a) kriteret për dhënien nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të lejeve të papaguara, për të gjithë prokurorët që ushtrojnë funksionin si pjesë e sistemit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë. Lejet e papaguara për prokurorët e komanduar jepen nga vetë institucioni ku shërben prokurori i komanduar për periudhën që shtrihet brenda kohëzgjatjes së komandimit;

b) procedurat që ndiqen në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për dhënien e lejeve të papaguara.

Neni 2**Përkufizime**

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Ligji për statusin” është ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) “Kodi i Punës” është ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

c) “Leje e papaguar” është leja për të cilën prokurori nuk paguhet gjatë kohëzgjatjes së saj;

d) “Këshilli” është Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

e) “Komisioni” është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës;

f) “Prokurori më i lartë” është prokurori sipas kuptimit të nenit 2, germa “c”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

g) “Drejtuesi i prokurorisë” është drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku prokurori ushtron funksionin.

Neni 3**Parime kryesore**

Prokurorët në paraqitjen e kërkesave për leje dhe Këshilli në procedurën e shqyrtimit të tyre, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të mëposhtme:

a) parimi i nxitjes së profesionalizmit dhe zhvillimit të karrierës, sipas të cilit, prokurori nxitet t’i japë rëndësi vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale;

b) parimi i efikasitetit, sipas të cilit prokuroria duhet të jetë funksionale për përmbushjen e misionit të dhënies së drejtësisë;

c) mbrojtja e të drejtës për jetë private dhe familjare, duke ruajtur konfidencialitetin, sipas rastit.

Neni 4**Llojet e lejeve të papaguara**

Lejet e papaguara që u jepen prokurorëve nga Këshilli janë:

a) Leja prindërore, sipas nenit 24, pika 2, të ligjit për statusin dhe nenit 132/1, të Kodit të Punës;

b) Leja për qëllime kualifikimi dhe specializime në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së formimit vazhdues, sipas nenit 24, pika 3, të ligjit për statusin;

c) Leja për arsye familjare ose shëndetësore, sipas nenit 24, pika 3, të ligjit për statusin.

Neni 5**Kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes prindërore**

1. Leja prindërore i jepet prokurorit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë, për çdo fëmijë në ngarkim, derisa fëmija të arrijë moshën 6 vjeç. Për shkaqe të motivuara, Këshilli mund ta kufizojë kohëzgjatjen e periudhës së lejes prindërore të kërkuar nga prokurori, por në çdo rast, jo më pak se 4 muaj.

2. E drejta për të kërkuar lejen prindërore është individuale për secilin prind dhe nuk është e transferueshme, me përjashtim të rasteve kur njëri prind humb jetën. Leja mund të jepet e ndarë, por jo më pak se një javë në vit.

3. Në rastin e birësimit të fëmijës, leja prindërore jepet brenda 6 vjetëve, që nga dita e birësimit të fëmijës, por jo më vonë se kur fëmija mbush moshën 12 vjeç.

4. Prokurori që kërkon këtë leje, e paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje, si dhe përcakton kohëzgjatjen e saj. Bashkë me kërkesën,



prokurori paraqet dokumentacionin justifikues dhe mendimin me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë.

5. Kërkesa e prokurorit trajtohet nga Komisioni, i cili brenda 7 ditëve i përcjell mbledhjes plenare propozimin për miratimin e lejes dhe afatin e fillimit të saj. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda dy javëve nga paraqitja e propozimit.

6. Në rast të cenimit të funksionalitetit apo përmbushjes së detyrës me eficiencë dhe në kohë, Këshilli mund të shtyjë datën e fillimit të lejes deri në 6 muaj.

Neni 6

Kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për qëllime kualifikimi dhe specializimi

1. Leja për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi jepet nga Këshilli, për një periudhë jo më shumë se dy vjet.

2. Prokurori që kërkon këtë leje paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për ndjekjen e këtij trajnimi, afatin e lejes dhe të dhëna për institucionin trajnues. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues, si dhe mendimi me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të zyrës së prokurorisë.

3. Kërkesa e prokurorit trajtohet nga Komisioni, i cili brenda 7 ditëve i përcjell mbledhjes plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit.

4. Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së prokurorit, por në total jo më shumë se 2 vjet.

5. Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, nëse kualifikimi profesional ose specializimi nuk përputhet me funksionin e prokurorit, ose nëse ajo bie ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me eficiencë dhe në kohë.

Neni 7

Leja e papaguar për arsye familjare ose shëndetësore

1. Leja për arsye familjare ose shëndetësore deri në 30 ditë, sipas nenit 96, pika 2 ose sipas nenit 132,

pika 1, fjalia e fundit, të Kodit të Punës, jepet nga drejtuesi i prokurorisë, ndërsa për vetë drejtuesin e prokurorisë, leja jepet nga Prokurori i Përgjithshëm.

2. Nëse kërkesa për leje të papaguar paraqitet nga drejtuesi i një prokurorie, e cila në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk ka zëvendës drejtues të zgjedhur, Prokurori i Përgjithshëm njofton Këshillin, të paktën 3 ditë para miratimit të lejes. Në raste urgjence, ky njoftim bëhet menjëherë pas paraqitjes së kërkesës nga drejtuesi i prokurorisë dhe në pamundësi menjëherë pas miratimit të lejes.

Neni 8

Kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes për arsye familjare ose shëndetësore që jepen nga Këshilli

1. Këshilli mund të japë leje për arsye familjare ose shëndetësore për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet.

2. Prokurori që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Në rast të nevojave urgjente kërkesa paraqitet menjëherë pa vonesë. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes dhe afatin e lejes së kërkuar. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues, si dhe mendimi me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të zyrës së prokurorisë.

3. Kërkesa e prokurorit trajtohet nga Komisioni, i cili brenda 7 ditëve i përcjell mbledhjes plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë, brenda dy javëve nga paraqitja e propozimit.

4. Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së prokurorit, por në total jo më shumë se 2 vjet.

5. Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me eficiencë dhe në kohë.

Neni 9

Ndërprerja e lejes së papaguar me kërkesë të prokurorit

Në çdo kohë gjatë periudhës së lejes, prokurori mund t'i drejtohet Këshillit me kërkesë të arsyetuar,



të shoqëruar me dokumentacionin justifikues, për ndërprerjen e lejes së papaguar të dhënë nga Këshilli.

Neni 10
Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËRKESË
Nr. 362/14, datë 27.9.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private të cilat preken nga Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “njësi”, bazuar në

pikën 3, të VKM-së nr. 138., datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 6,278,426.40 (gjashtë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë pikë dyzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK
NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE”, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Shënime (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	
													Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Ndërtesë” (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera sipas situacionit (lek)		
1	Agim Vjosa Kujtim	Ismail Ridvan Mynir	Cani Skendo Kryeziu	Tiranë	8240	3/168-ND	Ndertesë	68.53	68.53	68.53	65,000	4454450.00	4,454,450	Shteti është pronari i truallit 3/127 në të cilin ndodhet ndërtesa 3/168, diferenca dokument-fakt është 15 m². Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin.
2	Agim Vjosa Kujtim	Ismail Ridvan Mynir	Cani Skendo Kryeziu	Tiranë	8240	3/170-N1	Njësi	176	176	176	Vlerësim sipas ekspertit	1,823,976.4	1,823,976.4	Shteti është pronari i truallit 3/127 mbi të cilin ndodhet ndërtesa 3/170-n1. Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e marrëdhënies me truallin.
SHUMA PARAPRAKE													6,278,426.40	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 381, datë 16.5.2023, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzi Petanaj, i datëlindjes 8.8.1966, lindur dhe banues në Vlorë, me datë vdekjeje 25.11.1995.

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në njoftimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për hyrjen në fuqi të “Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Mbrojtjen Shoqërore”, nënshkruar më 18.2.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 1.8.2023, **data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndryshohet nga “1.11.2023”, në “1.10.2023”.**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë